

SHQIPONJA - SIMBOLI MË I LASHTË I BESIMIT NË EURO-AZI

Fatbardha **DEMI**¹

"Emri i vjetër nuk tregonte vetëm kombësinë, por edhe besimin."

Osman **MYDERRIZI**

PËRMBLEDHJE

Besimi dhe Atdheu, ka qënë zanafilla e lëvizjes më të fuqishme ideore dhe kulturore e elitës shqiptare të shekullit 17-19, që në historinë botërore njihet me emrin e përgjithshëm rilindje. Ajo që e bashkonte lëvizjen shqiptare me atë europiane ishte fakti se: Frymëzuesit dhe veprimtarët e saj, kanë qënë nga rradha e figurave të shquara intelektuale. Synimi për të zbuluar dhe mbledhur pasurinë e traditës (folklorike-besimtare) dhe historike të Kombit shqiptar, e cila do të dëshmonte karakterin e ndryshëm etnik me popujt e tjerë dhe origjinën e lashtë. Përkushtimi ndaj çështjes kombëtare. Por, kjo lëvizje kulturore në fillim, dhe çlirimtare më vonë (shk19-20), tek shqiptaro-arbërit kishte shumë dallime nga lëvizja europiane, si për shkaqet e lindjes, ashtu edhe rrugën e ndjekur dhe autorët kryesorë të saj. Një prej këtyre dallimeve ka qënë fakti, se zuri fill në shek. - 17 në «shtëpinë e Zotit » në gjirin e eruditëve kishëtar, jashtë truallit të saj natyror, e pafinancuar dmth vullnetare dhe shkaku, ishte i natyrës fetare. Siç dihet mbas vdekjes së Skënderbeut (1467) dhe pushtimit Osman, së bashku me familjet shqiptëtare, u larguan drejt Gadishullit italik edhe përfaqësuesit e besimit të krishterë lindor të shqiptarëve. Përveç vështirësive që gjetën në tokën e Papatit katolik për pranimin dhe ushtrimin e riteve të besimit të tyre ortodoks bizantin, një problem i madh shpirtëror ishte trajtimi i tyre, si etni dhe besimtar të Kishës Greke. U pa e domosdoshme të dëshmohej në « atdheun e dytë » karakteristikat etnike dhe Historia e vërtetë e Kombit shqiptar. At Nikoll Keta iu mësonte nxënësve të tij se: «Studimi i historisë së paraardhësve, buronte nga një kureshtje e ligjshme vetjake, si kërkesë e vetë natyrës njerëzore, meqënëse ky veprim ishte shprehje e vullnetit dhe dashurisë Hyjnore»

Fjalë kyçe: Shqiponja, simbol i Europës; Emblema e shqiponjës; Gjuha shqipe-arbërore.

HYRJE

Historiografia përcakton dy burime, nga është huazuar simboli i shqiponjës prej mbretërive mesjetare:

1. Perandorinë romake, për Europën perëndimore dhe qendrore;
2. Perandorinë Bizantine e dinastisë së Paleologëve të shekullit 15, për ato të Europës lindore.

Të dhënat historike tregojnë se, Shqiponja është simboli i përdorur ndër shekuj prej Perandorive më të fuqishme të historisë së periudhës së vonë të Lashtësisë dhe Mesjetës europiane, por edhe nga mbretër, principata dhe familjet fisnike. Edhe në kohët moderne ka qënë një nga simbolet e lakmuara për të dëshmuar "lidhjet historike", të popujve europian me perandoritë e lashta apo si "shprehje e forcës së tyre dhe ndihmës hyjnore", në formacionet ushtarake. Ajo që duhet theksuar është fakti se në Europë, Shqiponja ka qënë simbol i përdorur nga elitat e pushtetit, të cilat janë frymëzuar nga mitet dhe trashëgimia arkeologjike e lashtësisë. Gjithashtu del në pah se, kjo figurë nuk ka përfaqësuar simbolin kryesor në traditën besimtare dhe kulturore të nënshtetasve të tyre. Nga ky fakt, dalim në përfundim se ky simbol është huazuar nga këto elita. Në këtë "huazim" të

¹Studiuese, botuese librash, fatbardha_demi@yahoo.com

figurës së shqiponjës, ku gabimisht përmenden edhe principatat e Arbërve, përjashtim bëjnë vetëm ato mbretëri, principata, familje dhe ushtri të bashkësive fisnore dhe popujve, që me simbolin e Shqiponjës kanë shprehur karakterin e tyre kombëtar.

Shqiponja është figura qendrore në ligjërimin biblik të kristianizmit dhe simboli më i lashtë besimtar i Zotit në Euro-Azi. Ajo përmendet nga apostulli i Jezu Krishtit-Simone, i njohur me emrin Shën Pietri (shek. I p.K.), Papa i parë i Kishës katolike. Për teologun romak-Ireneo (*Irenaeus*; 130-202), figura e shqiponjës është simbol i ngjitjes në qiell të Krishtit. Shumë predikues dhe pjesë të shkrimeve biblike, e marrin jetën e Shqiponjës si figurë krahasimi të veprimeve të Krijuesit. Ky vënd qendror që zë Shqiponja në ligjërimin dhe teologjinë e kristianizmit, e ka origjinën nga besimi i qytetimit të parë të Euro-Azisë, ay i Pellazgo-Arbërve. Ky përfundim (krahas fakteve të tjera) bazohet tek dialektet e gjuhës së Shqipëtarë-Arbërve të kohëve moderne, duke u nisur nga tre emrat e përmendur gjatë tekstit:

1. Shqipëtar, 2. Komb dhe 3. AIN.

Në dialektin tosk të Çamërisë, fjala "ipe" emërton Shqiponjën: (i+pe), ku «I», sipas eruditit arbëresh Xhuzeppe Katapano, "në doktrinën e Thotit përfaqëson Fuqinë Krijuese të Zotit është vetë *FJALA*" (34) + folja e kohës së shkuar – pashë/veta e dytë, njejes/ (ti) pe. Ky emër do të thotë: "Zotin pe". Ky simbol i përket periudhës zanafillore të shoqërisë njerëzore – matriarkatit, nga e ka origjinën edhe miti i "syrit hyjnor".

Kuptimi mitik i fjalës Kom, është, se arbërit janë fise "të lidhura me Zotin". Kjo është edhe arsyeja që fjalës Komb i ngjitet edhe figura e Shqiponjës, që shpreh gjithashtu "lidhjen me Zotin" (kombësia shqiptare). Xh. Katapano na zbulon se, në të folurën e arbëreshëve të Italisë, emri i simbolit besimtar *AIN*, përdorej për Shqiponjën, i cili "fshihej" nga teologjia kristiane nën emërtimin e "shpirtit" dhe "fjalës" (logos) së Krijuesit. Në mitin kristian, Kryqi është objekt simbolik i sakrificës së Krishtit për hir të njerëzimit, por nuk është simbol që shpreh Zotin apo të dërguarin e tij, siç është simboli i Shqiponjës.

Duke u bërë i njohur ky fakt shkencor, historik dhe besimtar, i popujve të zhdukur dhe i trashëguar tek Shqipëtarë-Arbërit e sotëm, do të sillte një ndryshim thelbësor në shkencën e Historisë Botërore. Në asnjë fjalor gjuhësor apo historik të Botës, nuk gjëndet një emër, i cili të shpreh: familjen, mitin, besimin, traditën, gjuhën, përkatësinë etnike, simbolin e flamurit, historinë dhe moshën parahistorike të një popullsie, botëkuptimin dhe të organizimit zanafillor ligjor, siç është emri i Shqipëtarë-Arbërve të sotëm - Shqipëtar dhe Komb - shumë më herët se të kishin shtetin e tyre. Dihet gjithashtu se, simbolet dhe ritet fetare të lashtësisë, gjatë mijëra-vjeçarëve janë kthyer në tradita kulturore që tregojnë veçoritë historike e botëkuptimore të popujve, siç është edhe rasti i simbolit besimtar të Shqiponjës tek shqipëtarët.

1. SHQIPONJA, SIMBOLI MË I LASHTË I BESIMIT NË EURO - AZI

Nuk mund të kemi "një të sotme" të suksesshme, pa njohur "dritën e së vërtetës historike", Marcus Tullius Cicero. Një emocion i rastësishëm, mbas dy golave vendimtarë në portën e përfaqësueses së Serbisë në Kampionatin botëror të futbollit (Moskë, 2018) i lojtarëve shqipëtarë të skuadrës zviceriane Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit, vuri në qendër të vëmendjes së opinionit botëror simbolin shtetëror të shqipëtarëve - *SHQIPONJËN*.



Vendimi i FIFA-s dhe trajtimi që iu bë në masmedia domethënies së simbolit të shqiponjës (së shprehur nga shqipëtarët), zbuloi mangësitë e rëndësishme në shkencën Historike e Besimtare, në mjedisin shkencor, intelektual dhe politik të Ballkanit dhe Europës. Për të mbushur sadopak këtë zbrazëti në shkencat e mësipërme, do të trajtoj faktet që lidhen me këtë simbol parahistorik të Euro-Azisë dhe të Kombit tonë. Shqiponja, simbol administrativ në historinë e mbretërve dhe shteteve

Nga një gjurmim i thjeshtë nëpër faqet e internetit vërejmë se në ditët e sotme si simbol shtetëror në Europë, Shqiponja përfaqëson shtetin shqipëtar, të Malit të Zi, Serbisë dhe të Moldavisë, pa u zgjatur këtu me shtetet që e kanë si stemë të institucioneve ushtarake. Përdorimi i këtij simboli në flamur si një mënyrë identifikimi të kalorsisë, e gjejmë të përhapur, sidomos në Europën qendrore dhe lindore në shekullin e XII dhe si emblemë, në fund të shekullit XIV, e përdorur nga elita perëndimore e klerikëve, fisnikëve, borgjezisë dhe më vonë, për të përfaqësuar korporata të mjeshtërive dhe shoqatave të ndryshme.

Si simbol i pushtetit, figura e Shqiponjës në Europë është përdorur nga: Perandoria e Shenjtë Romake (63p.K. - 476p.K.), Bizantine (330 – 1453), e Karlit të Madh (742/748 – 814), nga Perandoria e Shenjtë romako – gjermanike, e cila përfshinte të gjithë Europën qendrore (962 – 1806), Napoleoni (1804-1814) e Perandoria e Austro-Hungarisë (1867-1918), si dhe disa principata dhe mbretëri mesjetare.

Simbolet besimtare në shtizën që mbahej gjatë betejave të ushtrisë romake, në krye të së cilave qëndron Shqiponja. Toledo, stema e mbretërve katolikë me simbolin e shqiponjës dhe shigjetat e Zeusit, djathtas. Rrethi në kokë shpreh natyrën hyjnore dhe rolin e saj ndërmjetës me Zotin. Në trevat e Arbërve, Shqiponja dykrenore ka qenë emblemë e dyerve fisnike të Gropajve, Muzakajve, Aranitëve, Kastriotëve dhe Shqiponja me një kokë, e Zakariajve dhe Buzëzezëve (f. 50 Jaho Brahaj "Flamuri i Kombit Shqiptar" 2007) dhe e shtetit të Gjergj Kastriot Skënderbeut (1443-1468)





Vula e Skënderbeut.

Emblema e shtetit të Skënderbeut dhe vula e tij ku dallohen gërmat D dhe AL (Dominus Albanus –Zot i Albanëve).

Pjetri I-rë (1682-1725), krijuesi i një perandorie të re në lindje të Europës, gjithashtu e përdori figurën e Shqiponjës, por me ngjyrë të florinjte, në dallim nga ajo e zezë, e dinastisë së Romanovëve të shk17, e ndjekur nga Bullgaria, Hungaria, Mali Zi, etj. Shumë klube sportive, si edhe ato të futbollit të ditëve të sotme, nuk mbetën mbrapa për ta përfaqësuar veten me këtë simbol, si ai i qytetit të Aquilas, Katanzaros, Lazios, etj. në Itali. Nuk janë të paktë gjithashtu sportistë të futbollit, të cilët i shprehin emocionet e tyre me shqiponjën, si “shenjë të fitores”. Spanja e Luis Enriques fitoi 6-0 ndaj Kroacisë në Ligën e Kombeve, por ajo që ra në sy në takimin e zhvilluar në Elçe ishte festimi i golit nga ana e Sergio Ramos. Historiografia përcakton dy burime, nga është huazuar simboli i shqiponjës prej mbretërve mesjetare: 1. Perandorinë romake për Europën perëndimore dhe qendrore; 2. Perandorinë Bizantine të dinastisë së Paleologëve të shekullit 15, për ato të Europës lindore.

Nisur nga faktet e sipërpërmendura, vërejmë se: Të dhënat historike tregojnë se Shqiponja është simboli i përdorur ndër shekuj prej Perandorive më të fuqishme të periudhës së vonë të Lashtësisë dhe Mesjetës europiane por edhe nga mbretër, principata dhe familjet fisnike. Edhe në kohët moderne ka qenë një nga simbolet e lakmuara për të dëshmuar lidhjet historike, të popujve europian me perandoritë e lashta apo si shprehje e forcës së tyre dhe ndihmës hyjnore, në formacionet ushtarake.



Ajo që duhet theksuar është fakti se në Europë, Shqiponja ka qenë simbol i përdorur nga elitat e pushtetit, të cilat janë frymëzuar nga mitet dhe trashëgimia arkeologjike e lashtësisë. Gjithashtu del në pah se kjo figurë nuk ka përfaqësuar simbolin kryesor në traditën besimtare dhe kulturore të nështetasve të tyre. Nga ky fakt, dalim në përfundim se ky simbol është huazuar nga këto elita. “Me anë të martesave dhe dhënies së privilegjeve, Bizanti ia dhuroi simbolin Perandorak (të Shqiponjës - shënim) fisnikërisë së mbretërve, që ishin integruar në këtë Perandori shumë etnike si: Princave Rumunë, Bullgarë, Gjermanë, Rusë, Serbë, Grekë, Shqiptarë, etj. Kjo është arsyeja që këtë simbol sot e përdorin një dyzinë popujsh e shtetesh, të cilat dikur kanë pasur kontakte kulturore me Bizantin. Ndërkohë ai shfaqet si simbol edhe i kishës Ortodokse, pasardhëse e drejtpërdrejtë e Perandorisë së Lindjes, Bizantit”.

Në këtë “huazim” të figurës së shqiponjës, ku gabimisht përmenden edhe principatat e Arbërve, përjashtim bëjnë vetëm ato mbretëri, principata, familje dhe ushtri të bashkësive fisnore dhe popujve që me simbolin e shqiponjës kanë shprehur karakterin e tyre kombëtar. Për të kuptuar arsyen e vendit të veçantë që ka patur figura e shqiponjës në historinë europiane dhe veçanërisht

tek Shqipetaro- Arbërit, rol vendimtar ka rruga kërkimore që duhet ndjekur dhe në rastin tonë, ajo përfshin tri kushte:

1. Nuk duhet të nisemi nga dokumentet e periudhave mesjetare, si dhe të lashtësisë së vonë (kur flasim për perandorinë romake) siç ndodh shpesh kur flitet për shqiponjën.
2. Nuk duhet parë thjesht si "shpend i maleve", por si figurë simbolike e botëkuptimit të njeriut, e cila ka një zanafillë kohore.
3. Përdorimin e metodës shkencore, e cila përfshin në kërkimin e saj, hapësira pa kufij shtetërorë dhe tek popuj që e kanë dëshmuar vijëmsinë e mbijetesës së tyre ndër mijvjeçarë, që sot emërtohen "popuj natyrorë" apo të zhdukur tashmë dhe duke ndjekur të vetmin shteg të mundshëm – gjuhën dhe besimin - zanafillor të tyre në Euro-Azi (Europën parahistorike mesdhetare). Kur theksoj "gjuhën" dhe "besimin" kam parasysh faktin se të dyja këto burime gjenden të dokumentuara në shumë shkenca të sotme, si në Arkeologji, Etnografi, Mitologji, Histori, Gjuhësi, Folklor, Antropologji, Gjeologji, Psikologji, Gjenealogji, etj. Fakti i përhapjes së këtij simboli në të dyja format (me një apo dy krerë) në shumë Kontinente dëshmon natyrën besimtare të përdorimit të figurës së saj.

Deri më sot, nga ana e FIFA-s dhe media europiane nuk është dënuar dhe akuzuar për "simbol politik" asnjë sportist kur para ndeshjes ose si shënjë falenderimi për fitoren, ka bërë kryqin kristian, megjithë faktin që ky simbol, ndodhet në shumë flamuj shtetërorë (të Greqisë, Zvicrës, Anglisë, Suedisë etj.) dhe dihen konfliktet e përgjakshme historike të popujve europianë, të periudhës mesjetare dhe moderne, të udhëhequr nga ky simbol, siç ka ndodhur edhe gjatë luftës në Kosovë (5 mars 1998- 11 qershor 1999).

Për ironi të fatit, jo vetëm vendimmarrësit e FIFA-s por edhe studiuesit Albanologë nuk e dinë se: Shqiponja është figura qendrore në ligjërimin biblik të kristianizmit dhe simboli më i lashtë besimtar i Zotit në Euro-Azi. Ajo përmendet nga apostulli i Jezu Krishtit Simone, i njohur me emrin Shën Pietri (shek. I p. K.), Papa i parë i Kishës katolike i cili sipas dokumenteve shkrimore, fillimisht ka ligjëruar në Iliri para se të hidhej në bregun perëndimor të Adriatikut. Ai i këshillonte paganët që të ndiqnin sjelljen e saj: "Në gjueti, Shqiponja nuk e humbet dinjitetin. Ajo zbret rrufeshëm nga lartësitë por jo për të rënë në baltë apo të qëndruar në tokë. Edhe ne nuk shkojmë drejt mëkatit të një jete të pamoralshme dhe nuk harrojmë se Krijuesi na ka çuar drejt lartësisë". (2 Pietro 2:20,21).

Për teologun romak- Ireneo (*Irenaeus*; 130-202), të cilin të dyja Kishat (katolike e ortodokse) e mbajnë për "shenjt" dhe si një prej "baballarëve" të saj, figura e Shqiponjës është simbol i ngjitjes në qiell të Krishtit: "Pas ringjalljes së tij si një shqiponjë, ai u ngrit drejt qiellit. Për rrjedhojë, për ne është gjithshka: njëri për nga lindja, viçi për nga vdekja, luan në ringjalljen e tij, Shqiponjë në ngjitjen në qiell". Shumë predikues dhe pjesë të shkrimeve biblike e marrin jetën e shqiponjës si figurë krahasimi të veprimeve të Krijuesit dhe simbolit të ringjalljes: "Zoti, sikurse Shqiponja i përkushtohet popullit të tij duke e çuar me kujdes drejt shpëtimit, drejt lartësive duke i mbajtur mbi krahët e tij". "Shqiponja është simbol i rinisë së përvetshme (Ps. 102, 5) dhe "vendosjes së drejtësisë së Zotit kundrejt popullit jo besimtar..." (Sal 103,5); (Os 8,1). (10)

Figura e saj merret si shembulli kryesor në mësimet dhe ngjarjet biblike, si tek: (Ebrei.9:14;1Pietro 1:18,19), (Esodo 19:4; Deut.32:11,12), (Giobbe 39:27), (1Re 4:31...), (Levitico 11:13), (Efesini 4:15; 1 Pietro 2:1-2; Atti 18:25-26), (Gen. 7:8-9), (Apoc. 12:13,14), (Proverbi 30:18,19), (1 Tessalonicesi 4:13...), (Ezechiele 1:10), (2 Cronache 9:3-5), dhe të shumë apostujve të tjerë të kristianizmit. Kjo është arsyeja, që në objektet e kultit kristian e shikojmë Shqiponjën duke mbajtur librin e Biblës (fig.1), pranë figurës së Krishtit në tavanet e Kishës apo sipër fronit të prelatëve kryesorë dhe figurat e shumta të shenjtoreve dhe engjëjve të paraqitur me krahët e saj, si përcjellës të fjalës apo të dërguarin e Zotit.



Libri i Biblës mbi një Shqiponjë në kishën e St. Nicholas, Blakeney, Norfolk, në Angli, por edhe në katedralet e S. Pietro, S. Paolo, S. Andrea në Pjetërburg (Rusi), Irlandë e deri në objektet e kultit katolik në Australi. 2. Papa Françesku duke shprehur simbolin e Shqiponjës. Teologjia kristiane dhe rryma të tjera të lidhura me të, për përhapjen e mësimave fetare, janë nisur nga jeta e saj në natyrë, pa e zbërthyer kuptimin simbolik që ajo mbart, për të cilin padyshim kanë dijeni “të Diturit” e Kishës, siç e dëshmon edhe vendi i rëndësishëm që zë në artin e objekteve të kultit kristian dhe veshjen e prelatëve më të lartë të kishës ortodokse dhe kopte. Nisur nga ky fakt do ta gjurmojmë figurën e Shqiponjës, jo si gjallesë e botës së shpendëve por si simbol në shkencën e besimit.

Njohësja e mirë e besimeve të lashta e të reja dhe mitologjisë, H. Blavatsky (*Il Clossario Teosofico*), duke folur për katër simbolet e besimit (njeriun me krahë, luanin, kaun dhe Shqiponjën), të pasqyruara në librin e evangjeliëve të cilin e lexonin kristianët e parë, pohon se: “Shqiponja (e Shën Xhovanit) përfaqëson Shpirtin kozmik ose Ajrin, Syrin e Gjithpushtetshëm të Profetit”. Për katolicizmin, “syri hyjnor” apo “Syri që shikon gjithçka” i Zotit –At, të gjithëditurit dhe të kudondodhur, gjendet i shprehur në Psalmin 33:18 dhe ligjërimet biblike: (Matt. 20:15), (Prov. 22:9), (6:17 marg.), (Isa. 3:16), etj. Ky vend qëndror që zë Shqiponja në ligjërimin dhe teologjinë e kristianizmit, e ka origjinën nga besimi i qytetërimit të parë të Euro-Azisë, ai i Pellazgo-Arbërve. Ky përfundim krahas fakteve të tjera, bazohet tek dialektet e gjuhës së Shqipetaro-Arbërve të kohëve moderne.



Studiuesja e filozofisë teosofiste (théosophie) H. Blavatsky, dukefolur për emërtimin AIN Soph, që përdoret në ligjërimin biblik, pohon se sipas filozofit Filone i Alessandrisë v.20– 45p. K. *Quaestiones et Solutiones in Genesis*, AIN Soft, është “Zoti i Dytë dhe Mënçuria e tij”, është një Hyjni që simbolizon “ASGJË”, është e paemër, prandaj edhe quhet “Ain Soph” sepse fjala “Ain” do të thotë asgjë dhe në gjuhën hebraike, ain simbolizon atë që nuk ekziston. (16)

Në gjuhën hebraike, arabe, caldaike dhe siriane, emri Ain tregon syrin. (*Appunti sui primi elementi di lingua ebraica*. Gastone Ventura) (17) Syri në këto alfabetë të mësipërme, shpreh gërmën “O”, me kuptimin e “hiçi-it”. Studiuesi erudit P.Zheji (*Shqipja dhe Sanskritishtja*) pohon se “Simboli 0 është ai i qëndrës, i Frymës, i Zotit (...) Hiçit në hebraisht i thonë AIN dhe shpreh Krijuesin që nuk mund të njihet”. Ain quhej edhe qyteti Levit në tokat e tribuve të lashta Judaike dhe ‘Ain Giälūt në Palestinë e vënde të tjera të Azisë (19), por edhe të Europës, sidomos në vendbanimet e popullsisë baske (Spanjë, Gadishulli Iberik).

Në këtë gadishull, gjenden shkrime të lashta të ngjashme me ato të Etrurisë (Itali) dhe Ilirisë (Shqipëri) që lexohen vetëm nëpërmjet gjuhës shqipe (Nermin Vlora Falaski, *Pellazgët-Ilirët-Etruskët-Shqipëtarët*), sikurse edhe vetë emri i kësaj popullsie (baschi = bashkë dmth grup fisesh, dhe gjuha e tyre Eskuera = e shkuara, e vjetra) të cilët në lashtësi adhuronin Kaun (simbol kultik i besimit hënor të Dodonës) si Perëndi dhe sipas Strabonit, formuan qytetimin iberik.


Sipas studiuesve spanjollë, emërtimi Ain është shumë i përhapur si mbiemër njeriu dhe toponim, i cili përfshin të gjitha vendbanimet e popullsisë Baske të sotme, që shtrihen nga komuna e Tafallës, ne veri të Spanjës dhe vendbanimet në vargmalet e Pirenejve. Edhe emri Pirene e ka origjinën nga gjuha shqipe për Shqiponjën, sikundër edhe ay i gadishullit Iberik (21). Gjuhëtarët janë të mendimit se është një toponim blektoral dhe bujqësor por deri më sot, domethënja e emrit *AIN* është akoma e pazgjidhur. Si përfundim del se, studiuesit deri më sot, për simbolin mitik dhe besimtar - AIN nuk kanë dhënë dot shpjegimin e kuptimit gjuhësor, në të folurën e popujve të lashtë dhe të sotëm të Euro-Azisë. (do të shtjellohet më poshtë).

Le t'i kthehemi përsëri figurës së Shqiponjës, në Fjalorin e H.Blavatsky: "Të katër simbolet kryesore të librave evangjeliqë që lexonin kristianët e parë (njeriun me krahë, luani, kau dhe Shqiponja -shën im) janë të Egjiptianëve, Kaldejve dhe Indianëve". Mbi figurën e Shqiponjës në mitet e popujve të lashtë dhe simbolin e saj si "Syri hyjnor" i Krijuesit, është folur edhe në shkrimet e mëparshme, si dhe në librin kushtuar besimit të Pellazgëve (*Sellenizmi...*)(24) prandaj, këtu (për arsye të formatit të një shkrimi)do të ndalem mbi disa fakte të shprehura në objektet arkeologjike, vetëm të ... Egjiptit faraonik.

Kur folëm për përdorimin e simbolit të shqiponjës nga Perandoritë e lashta, për hir të së vërtetës historike, duhet ta nisim listën me perandorinë e mbretërve Atlantidë - Pellazgë, vijues drejtpërdrejt të së cilës kanë qenë Mbretër të hyjnizuar në Olimp dhe Dinastitë faraonike të Egjiptit, shkëlqimi i së cilës përfundoi me bëmat e Aleksandrit të Madh (320-356 p. K.).

Studimet e shumta flasin se paraardhësit e Faraonëve kanë qenë me origjinë nga Atlantidet-Arianë që shpëtuan nga përmbytja. Për këtë popull, që cilësohej me një qytetrim shumë të lartë, Platonit i kishte folur athinasi i shquar, Solon (640 p.K. - 558p.K.) sipas tregimeve të dëguara nga priftërinjtë egjiptian. Që Atlantidët, për të cilin janë shkruar afro 20000 libra, kanë qenë fise pellazgo-arbërore, e dëshmon në studimin e tij (*Thoti fliste shqip*), eruditi arbëresh Xhuzepe Katapano.

Mbretër pallazgë të ardhur nga Gadishulli Pellazgjik (Ballkani i sotëm) dhe ishujt e detit të mesdheut, duke pushtuar me luftë tokat në Afrikën veriore, përhapën besimin e tyre me idenë e njëzoti, me simbol kryesor Shqiponjën dhe Faraonin si të besuarin e tij. Nëmitet biblike, rolin e të dërguarit të Zotit e gjejmë të shprehur në figurën e Moisiut (lat. Moyses) dhe të patriarkëve të tjerë biblikë (Adamit, Noes, Abramit) duke mbërritur deri në ditët e sotme me mitin e Krishtit.



1. Shqiponja me fytyrë njerëzore, si përfaqësuese e Krijuesit, në rolin e shoqërueses së shpirtit të të vdekurit. Pikturë mbi sarkofagët e priftërinjve të Amonit (Zoti i egjiptianëve). Muzeu i Egjiptit në Firenze. 2. Figura e një priftëreshë me krahë shqiponje mbi sarkofagun e faraonit, që paraqet një periudhë më të vonshme kohore sesa ajo e fig.1. Në të djathtë, duket “syri hyjnor” që thekson rolin e priftëreshës si ndërlidhëse me Zotin. Në kristianizëm e gjejmë të përdorur në figurat e ëngjëjve mbrojtës dhe ikonat e shënjtoreve të hershëm biblik.

Në objektet arkeologjike të Piramidave, vërehet se Shqiponja, asnjëherë nuk shërben si mjet krahasues të jetës së saj në natyrë, siç predikohet në mënyre figurative në Bibël: “Ju e patë se çfarë ju bëra egjiptianëve dhe si Ju mora mbi krahët e Shqiponjës e ju drejtova drejt Meje” (Esodo 19:4). Kudo, si në formën e zogut, njeriut/zog apo njeriut me krahë shqiponje, në besimin dhe mitologjinë e Egjiptit, ajo përfaqsohet në rolin e: “shpirtit”, “të shoqëruesit drejt botës së përtejme”, të “mbrojtjes” së siguruar nga Krijuesi dhe si simbol i pushtetit hyjnor e të paprekshëm të Faraonëve.

Faraoni i parë që guxoi të zëvendësojë shqiponjën në rolin e përfaqësueses së Krijuesit, ka qënë mbreti Horos, i hyjnizuar si Perëndi. Në shumë skulptura, ai paraqitet si shqiponjë (figura poshtë) apo me kokën e saj (fig. 2,3).



1. Horos – Shqiponjë; 2- Faraoni Horos me kokën e Shqiponjes; 3. Studiuesit përgjithsisht e përcaktojnë si Perendinë diellore egjiptiane-Ra/Re.

Studiuesit modernë, duke mos e njohur besimin e lashtë hënor të Atlantidëve-Pellazg dhe pa e përkthyer drejt heroglifin Ra / Re (fig. 3) tek murret e piramidave, e kane trajtuar të njejtën figurë të Horosit, si perëndinë egjiptiane të Diellit – RA. Në fotot e internetit, nuk mungon edhe mendimi se kemi të bejmë me figurën e Horosit. Në fakt, në të dyja figurat është Horosi shqiponjë, në dy rolet e çdo faraoni: të Mbretit (fig.2) dhe të Priftit (fig.3) duke mbajtur në kokë Hënën e re, me një nga simbolet kultike të saj-gjarpërin. Edhe nëna e perëndisë Horos paraqitet po me një Hënë të kuqe mbi kokë dhe krahët e shqiponjës, duke treguar detyrën e saj të Kryepriftëreshës së besimit hënor, pohuar edhe nga Plutarku: “Ndërmjet statujave të saj me brirë, janë ato me Hënën e re”.

Emrin Re, Xh. Katapano e shpjegon me gjuhën shqipe me fjalën “rreze”, e cila në natyrë “lidh” qiellin me tokën dhe figurativisht kryen rolin e “ndërmjetësit”, siç është edhe detyra e mbretit-kryeprift Horos me kokë Shqiponje. Horusi ishte perëndia më e lashtë egjiptiane dhe figura e tij në objektet arkeologjike, gjëndet që në mjëvjeçarin e 3-të p. K. Emrin e tij e kanë mbajtur shume mbretër të dinastive egjiptiane dhe është adhuruar si mbrojtës i pushtetit të faraonit, të qytetit dhe si “prift i varrimeve”. Origjina e mitit të Horosit, u përket priftërinjve të qytetit Héliopolis, sipas të cilit, ay është biri i perëndisë Osiris dhe perëndeshës Isis. Kulti i tij nderohej veçanërisht në qytetin e lashtë Nekhen, i cili emërtohej “qyteti i Shqiponjës”.

Siç e dëshmojnë objektet arkeologjike, të gjithë mbretërit më të fuqishëm të lashtësisë, që u hyjnizuan në mite, janë “veshur me kostumin” e plotë apo të pjesshëm të Shqiponjës: në Europë, Afrikën veriore, Perandorinë perse të Azisë së Afërme, Indi, dhe qytetërimet e Amerikës qëndrore dhe jugore. Mbasi zbuluam shkurtimisht, rolin kryesor që ka luajtur simboli i Shqiponjës në qytetërimin egjiptian, të vendit të rëndësishëm që zinte në ligjërimin biblik, në artin e kristianizmit, si dhe në shkencën teosofike e trashëguar nga filozofia e “fshehte” e Lashtësisë, mbetet të gjejmë origjinën e përdorimit të saj besimtar, dmth: Kujt popullsie, vendi dhe periudhehistorike, i përket zanafilla e simbolit të Shqiponjës dhe e mitit të saj (syrit hyjnor) si përfaqësuese e parë e Zotit në Tokë?

Për këto pyetje, që shkenca Historike dhe Besimtare europiane dhe botërore i ka anashkaluar, do t’i drejtohem asaj popullsie, e cila me gjuhën e saj shpjegon kuptimin gjuhësor, besimtar dhe e përcakton periudhën historike, të Shqiponjës si simbol.

“Gjuha shqipe është një minierë ari” Kështu është shprehur Arif Mati, Doktor i shkencës së Lashtësisë, sipas titullit të Universitetit të Sorbonës (Paris 2012). Arsyeja e këtij pohimi është se në dialektet e popullit tonë, gjejmë faktet shkencore edhe për periudhat kohore “pa dokumente shkrimore” dhe “pa data”, siç do ta shtjellojmë më poshtë, duke u nisur nga tre emrat e përmendur gjatë tekstit: 1. Shqipëtar, 2. Komb dhe 3. AIN.

I. Rrënja e emrit Shqipëtar e trajtuar gjërësisht në një shkrim kushtuar emërtimit të popullit tonë (*Sellenizmi...* f. 94, 107) është *IPE*. Në fjalorin e gjuhës standarte shqipe, fjala *IPE* nuk ndodhet, por në dialektin tosk të Çamërisë, emërton Shqiponjën dhe tregon, se si besimi para-historik ka ndikuar në krijimin e fjalëve të reja. Njeriu primitiv, duke parë Shqiponjën si zogun e vetëm të lartësive të mëdha që mund t’i afrohej për ta parë Krijuesin, e gjykoi si ndërmjetësin e tij me të Plotfuqishmin. Ky mit pasqyrohet në gjuhën shqipe tek emri i Shqiponjës: *IPE* (i+pe), ku “I”, sipas eruditit arbëresh Xhuzepe Katapano, “në doktrinën e Thotit përfaqëson Fuqinë Krijuese të Zotit është vetë fjala” + folja e kohës së shkuar – pashë/veta e dytë, njejes/ (ti) pe. Ky emër do të thotë: “Zotin pe”. Ky emër çfaqet shpesh në folklorin e popullsisë së Çamërisë. Në një legjendë mbi Pirron e famshëm, Mbretin e Epirit lexojmë: “Kur Pirro qe i vogël e çuan tek mbreti i Shkodrës: “O mbret i nderuar/ t’u rritet nami e rrofsh e klofsh sa malet/ Kaha *Iperojana* të kemi ardhur/ të t’besojmë këtë zok të *ipes* / të na rritet ipje e vërtetë.

Emri ipe* i gjuhës shqipe, e shpreh origjinën e simbolit besimtar të Shqiponjës në botëkuptimin e njeriut para-historik europian, e më gjerë. Ky simbol i përket periudhës zanafillore të shoqërisë njerëzore – matriarkatit, që e gjejmë të përdorur edhe në ligjërimin biblik. Nga ky botëkuptim besimtar i Pellazgo-Arbërve për Shqiponjën, e ka origjinën edhe miti i “syrit hyjnor”, modelin e të cilit e gjejmë edhe në Muzeun e Butrintit në Sarandë. Faraoni/perëndi Horos, duke marrë rolin e shqiponjës, trashëgoi edhe mitin e “syrit hyjnor” i njohur në mitologjinë egjiptiane si “syri i Horosit”. Në një largësi të madhe gjeografike, në objektin e kultit të Aztekëve të Amerikës, në piramidat egjiptiane apo fiset sumere, shprehet miti se shqiponja është syri hyjnor zotit. Por, asnjë gjuhë e ndonjë populli të lashtë apo modern në botë, as edhe ajo sanskrite, nuk është në gjendje ta shpjegojë gjuhësisht. Këtë mit të Atlantidëve-pellazg (Zoti / Drita = Syri i Shqiponjës), e gjejmë vetëm në objektet arkeologjike.

II. Simboli besimtar i Shqiponjës lidhet edhe me tog-fjalëshin që emërton etnin tonë “Kombësia shqipëtare“, i cili e ka origjinën nga dy emra para-historik: Komb dhe Shqiponjë. Meqenëse emri i Shqiponjës u trajtua më lart, do të japim edhe kuptimin gjuhësor dhe mitik të emrit Komb, në gjuhën shqipe dhe botëkuptimin e Shqipëtar-Arbërve. Në dialektin e Çamërisë, kur duam të lidhim dy a më shumë fije, i themi “bëje kom”. Edhe në Fjalorin e gjuhës shqipe (2006) tek fjala Kom, lexojmë:

Komb- *Lidhje e shtrënguar e dy pjesëve a e dy anëve të një filli*, të një litari etj. ose e dy cepave të një shamie, pëlhure etj.; *nyje*. E lidhi komb. Zgjidh kombin. 2. Nyje druri, gdhë.

Komb - *Bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës*. Kombi shqiptar.

Rrënja zanafillore e falës “komb” është “kom“, sepse në gjuhën shqipe kemi fjalë, që shprehin bashkësinë apo lidhjen me këtë rrënjë, si: kom-unë, kom-shi. Në këtë formë e shkruan edhe Shtjefen Gjeçovi (*Trashëgime Thrako-Iliriane*): “Këto punë u rrfyen vetë goja e komit tonë, i cili, as s’ka dijtë me kndue tjetër kangë posë kangësh trimnijet, kangë luftet e kangë qindreset” (37) Kuptimi mitik i fjalës Kom, është, se arbërit janë fise “të lidhura me Zotin”. Kjo është edhe arsyeja që fjalës Komb i ngjitet edhe figura e Shqiponjës, që shpreh gjithashtu “lidhjen me Zotin”.

Për arësye të mos njohjes së tij, na duhet gjithmonë të rikujtojmë faktin se “emri Komb, shpreh botëkuptimin dhe karakterin historik të Shqipëtar-Arbërve, në dallim nga popujt e tjerë”. Ky sqarim, i cili mungon në materialet shkollore dhe studimore, gjendet në librin më të lashtë të ligjeve, në Europë - Kanunin e Lek Dukagjinit: “Familjen e përmbajn gjindja e shpis, si shtohen këta , dahren në vllazni, vllaznija në gjini, gjinija në fise, fiset në flamur e të gjith zbashku permblidhen në një Familje ma të hapët, e cila quhet Kom, e kan një atme (atdhe), një gjak, një gjuhë e doke”(Krye i dytë, Nye i nandët.Pjesëtarët e Familjes, *Kanuni i Lek Dukagjinit*) . Ky fakt rikonfirmon origjinën para-historike të simbolit të Shqiponjës nga bashkësitë fisnore të Pellazgo-Arbërve.

III. Ndërsa dy emrat e parë (Ipe / Komb) i përkasin zanafillës së lindjes së filozofisë besimitare të njeriut primitiv, emri i shqiponjës Ain i përket një filozofie teologjike të sofistikuar dhe “të fshehtë” deri në ditët tona.

Me ndihmën e librit të Xh.Katapanos zbulojmë se, në të folurën e arbëreshëve të Italisë, emri i simbolit besimtar *Ain*, përdorej për Shqiponjën, i cili “fshihej” nga teologjia kristiane nën emërtimin e “shpirtit” dhe “fjalës” (logos) së Krijuesit.

Emrin e Zotit-Al, të lidhur me atë të Shqiponjës- AIN, e gjejmë si toponim të qytetit 4.000 vjeçar në Emiratet e Bashkuara Arabe: Al-‘Ayn (العين), që shkruhet edhe Al-Ain dhe në kuptimin besimtar do të thotë “Zoti - Shqiponjë”.

Fakti që në mitologjinë e Atllantidëve-Pellazg të Egjiptit para-faraonik, perëndia Horos paraqitet si Shqiponjë dhe lidhet me simbolin “syri i Horosit”, mitin e të cilit e shpjegon vetëm gjuha e sotme shqipe, dëshmon se Shqipëtarë-Arbërit janë, trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të banorëve të parë të Kontinentit evropian që krijuan teologjinë besimtare dhe simbolet e para, që u përhapën valë-valë në pjesën më të madhe të Botës. Këtë fakt e ka shprehur i pari Herodoti (484 – 425 p. K.). Duke folur për mitologjinë besimtare të egjiptianëve dhe të gadishullit Pellazgjik (të dardano-helenëve), ai shkruan: “Nuk kam sigurisht qëllim të tregoj gjithë sa dëgjova për hyjnitë e tyre, porveç emrave të vet, se mendoj që të tërë njerëzit të njëjtat (gjëra) besojnë për hyjnitë”.

Pas Horosit pellazg, detyrën e përfaqësuesit dhe të ndëshkimit nga Zoti e morri Zeusi, këtë fakt e dëshmon Shqiponja që ka në dorë, siç paraqitet në shumë monedha dhe skulptura, apo pranë këmbëve të tij. Ay dërgoi Shqiponjën për ta ndëshkuar titanin Promete, sepse ju dha zjarrin njerëzimit (në kuptimin e diturisë), pronën e kryeperëndisë së Olimp-it-Zeusit. Objektet më të herëshme arkeologjike të lashtësisë, tregojnë se njeriu i cili ka marrë përsipër rolin e “ndërmjetësit” me Krijuesin, ka qenë femra me kokë zogu, të cilën arkeologia Maria Gimbutas, e ka emërtuar “Perëndesha Zog”, ndërsa për ne është “Perëndesha Shqiponjë” dhe gjendet në veshjen e traditës së gruas mirditore (Shqipëri). Kjo i përket zanafillës së periudhës së “matriarkatit”. (*Sellenizmi...* f.25)

Simboli i kryqit (në të dyja format e tij klasike ✝ / X) gjithashtu e ka origjinën në periudhën zanafillore, ku shprehte femrën e hyjnizuar si “riprodhuese” dhe shumë më vonë – Yllin, si simbol për Krijuesin (*Sellenizmi...* f. 65). Këtë simbol të besimit hënor pellazg (Hëna-Ylli) e gjejmë në qelshen e Aleksandrit të Madh dhe objektet e shumë qytetërimeve të zhdukura, i huazuar nga islamizmi dhe sot, në flamuj e disa shteteve të këtij besimi. Në mitin e kristianizmit, Kryqi është objekt simbolik i sakrificës së Krishtit për hir të njerëzimit, por nuk është simbol që shpreh Zotin apo të dërguarin e tij, siç është simboli i Shqiponjës.

Kjo “histori” mijërvjeçare që e trajtuam më lart, ndodhet pranë nesh në objektet arkeologjike dhe veprat e artit (3 fotot e mëposhtme) Ajo që mungon sot për të kuptuar “gjuhën e tyre”, është mosnjohja e besimit dhe gjuhës së Atllantidëve-Pellazo/Etrusk, stërgjyshërit para-historik i Shqipëtarë-Arbërve të sotëm.



1. Pjesë e skulpturës së Shqiponjës me përmasa gjigande. Shqiponja duhet të ketë qenë më shumë se 3 metra, duke marrë parasysh pjesën e këmbës (Muzeu i Durrësit). Modeli i plotë, por me madhësi natyrale, gjendet në Muzeun historik të Shkodrës. 2. Simbole të legjioneve romake. (Cortesie Chiesa di San Marcello in Corso - Roma-IT) Hëna poshtë simbolit të Zotit (rrethi me topthin në qender) në të tre shtizat, dëshmon besimin e

Zotit/Hënë në perandorinë romake, dhe (sipër) me simbolin kultik më të rëndësishëm-shqiponjën, në shtizën e mesit. 3. Skulptura moderne e Shqiponjës së ligjërimit biblik të hebrenjve, e ngjashme me objektin arkeologjik të Durrësit, në qytetin Haifa, porti më i rëndësishëm dhe që mbahet si kryeqyteti verior i Izraelit.

Besimi popullor- pohon Dhimitër Pilika- kudo në viset shqipëtare e nderojnë Shqiponjën si të shenjtë dhe të paprekshme (...) Atë e gjejmë në formë natyrale apo të stilizuar: mbi dru (arka, dollape, tavanë, djepe, lugë, furka, etj); mbi metal (kama, shpata, ene shtëpijake, zbukurime burrash dhe grash, pushkë etj); tekstil e lëkurë (opinga, rypa, kostume popullore, çorape, perde, qilima etj.); gur (qemere, vatra, kamare). Por, edhe në këngë, valle, emra njerëzish, toponime dhe si simbolin kryesor të Kombit dhe Shtetit tonë.

2. PËRFUNDIME

1. Simboli i Shqiponjës, si përfaqësuese e Krijuesit në Tokë është më i lashtë se simboli i Kryqit në mitin kryesor të kristianizmit. Duke u bërë i njohur ky fakt shkencor, historik dhe besimtar, i popujve të zhdukur dhe i trashëguar tek Shqipëtarë-Arbërit e sotëm, do të sillte një ndryshim thelbësor në shkencën e Historisë Botërore, por edhe të mëndësisë së Institucioneve të fushave të ndryshme dhe medias në përgjithsi.
2. Në asnjë Fjalor gjuhësor apo historik të Botës, nuk gjëndet një emër, i cili të shpreh: familjen, mitin, besimin, traditën, gjuhën, përkatësinë etnike, simbolin e flamurit, Historinë dhe moshën parahistorike të një popullsie, botëkuptimin dhe të organizimit zanafillor ligjor, siç është emri i Shqipëtarë-Arbërve të sotëm - Shqipëtar dhe Komb- shumë më herët se të kishin shtetin e tyre.
3. Siç u përmend në fillim të shkrimit, shumë simbole besimtare të ditëve të para të historisë njerëzore, përdoren edhe në kohët moderne nga njerëzit, popujt, shtetet dhe institucionet fetare, por pa njohur kuptimin e tyre të origjinës. Dihet gjithashtu se, simbolet dhe ritet fetare të lashtësisë, gjatë mijëra-vjeçarëve janë kthyer në tradita kulturore që tregojnë veçoritë historike e botëkuptimore të popujve, siç është edhe rasti i simbolit besimtar të Shqiponjës tek shqipëtarët.
4. Kjo popullsi, kur kërkon ta shpreh gojarisht përkatësinë etnike, përdor shprehjen, "jam me kombësi shqipëtare, dhe në çastet e emocioneve të forta dhe fitores së arritur, formon me dy duar - shqiponjën- simbolin e tyre besimtar/historik (për hir të së vërtetës, edhe i fiseve pellazge të Euro-Azisë në lashtësi).
5. Të dy sportistët e ndëshkuar padrejtësisht nga FIFA, si rrjedhojë e paditursisë së saj në shkencat e sipër-përmëndura dhe memecërisë së Albanologjisë zyrtare, emocionet e fitores, siç u shprehën edhe para medias, me simbolin hyjnor të shqiponjës, ja kushtuan pikërisht familjes, bashkombasve dhe të gjithë sport-dashëve të tyre në botë.

Paçin në jetë bekimin e Zot

